



Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave
me Aftësi të Kufizuar

GUIDË UDHËZUESE MBI TË DREJTËN PËR ARSIMIM

Guidë udhëzuese “Mbi dispozitat normative
(Për shkollat publike) arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta”

Financuar nga Komiteti Suedez i Helsinkit
Supported by Swedish Helsinki Committee

Swedish Helsinki Committee
for Human Rights

Qershor 2007

FSHDKPAK
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
Rruga "A.Z.Çajupi" (Bogdani) Pall.15 kat i 3, Tiranë
Tel/Fax 04 269426
www.adrf.org.al
adrf@albmail.com

Punoi
Koordinatorë e Programit Ligjor pranë FSHDKPAK
Av. Entila Zyba

Permbajtja

- Legjislacioni Shqipëtar që garanton të drejtën për arsim?
- Cila është natyra e arsimit parauniversitar në Shqipëri
- Cili është arsimiti shkollor i detyrueshëm me ligj, për tu ndjekur nga personat që kanë mbushur moshën për arsimim?
- Çfarë garanton Strategjia Kombëtare e personave me aftësi të kufizuar në fushën e arsimit gjithëpërfshirës?
- Çdo të kuptojmë me termin nxënës me aftësi të kufizuar?
- Sa është moshë e detyrueshme për pranimin në shkollë të fëmijës me aftësi të kufizuar si mendore/fizike?
- Drejtoria Arsimore (DA)?
- Detyrimi i Drejtorive Rajonale Arsimore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar
- Cila është fusha e zbatimit të "Dispozitave Normative për shkollat publike"?
- Si realizohet arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuar, sipas dispozitave normative?
- Si realizohet procesi i pranimit në këto shkolla?
- Po për ata fëmijë për të cilët shkollat publike nuk ofrojnë kushtet e nevojshme për arsimim, në cilat institucione mund të rregjistrohen për të vazhduar arsimimin?
- Sa është kohëzgjatja e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat speciale?
- Ku duhet të drejtohem për të marrë informacion të detajuar mbi arsimimin e fëmijës me aftësi të kufizuar?
- Cili është dokumentacioni që duhet të plotësohet për rregjistrimin për herë të parë të fëmijës në shkollë?
- Çfarë dokumentacioni duhet të plotësojë për rregjistrim në shkollë nxënësi me aftësi të kufizuar?
- Po në ato raste kur fëmija vjen prej një shkolle publike, çfarë dokumentash duhet të plotësojë?
- Sa është numri i nxënësve me aftësi të kufizuar, i detyrueshëm për çdo klasë?
- Në kompetencë të cilit institucion është hapja e shkollave speciale?
- Çfarë lehtësirash kanë mësuesit që punojnë me këtë kategori nxënësish?
- A ka të drejtë nxënësi me aftësi të kufizuar të largohet nga shkolla në të cilën është rregjistruar për të shkuar në një shkollë tjetër në të cilën ai ose prindërit e tij e gjykojnë më të mirë?

- A mund të realizohet arsimimi i nxënësit me aftësi të kufizuar edhe në ambjentin shtëpiak?
- Ç'farë programesh mësimore duhet të ndjekimin nxënësit me aftësi të kufizuar?
- A ndryshon programi dhe vëllimi i njohurive që marrin nxënësit me aftësi të kufizuar nga një kategori në tjetrën?
- Ç'farë lloj tekstesh mësimore përdoren për PAK?
- A mund të kryejnë orë mësimore nxënësit me aftësi të kufizuar së bashku me nxënësit e tjerë?
- Si bëhet vlerësim i nxënësve me aftësi të kufizuar?
- Ç'farë parashikon ligji për atë kategori nxënësish me aftësi të kufizuar të cilët kanë moshë më të madhe se nxënësit që mësojnë në klasën që ai frekuenton?
- Bashkëpunimi i personelit arsimor me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuar
- Në rast se jam nxënës me aftësi të kufizuar, a jam i detyruar të ndjek lëndën e edukimit fizik?
- Cilat janë të drejtat e nxënësve gjatë sistemit shkollor
- Cilat janë detyrat e nxënësve gjatë sistemit arsimor?
- Cilat janë të drejtat dhe detyrat e prindërve, në lidhje me procesin mësimor?
- A lejohet punësimi i fëmijëve të cilët janë të përfshirë në detyrimin shkollor?
- Cilat janë sanksionet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në lidhje me detyrimin për ndjekjen e procesit mësimor?
- Kush përjashtohet nga gjrobat?
- Ligj Nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"
- A mund të jetë formimi profesional vetëm publik?
- Cilat janë llojet e arsimit dhe formimit profesional?
- Cilat institucione ofrojnë arsimim dhe formimit profesional?
- Cilat kategori mund të jenë përfituese të arsimit dhe formimit profesional?
- Cili është institucioni kompetent për rregjistrimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional dhe dokumentacioni që ato duhet të plotësojnë për rregjistrim?
- Sa është afati i licencës?
- Kohëzgjatja në arsimin dhe formimin profesional
- Si bëhet vlerësimi përfundimtar në arsimin dhe formimin profesional?
- Ç'farë është Inspektoriati Kombëtar për Arsimin Parauniversitar (I K A P)?
- Ç'farë është Instituti i Studimeve Pedagogjike (ISP)?
- Ç'farë është Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve (QKAVP)

Programi ligjor pranë Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar ka përgatitur këtë guidë udhëzuese mbi të drejtën për arsimim në funksion të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuar, të prindërve, të personelit mësimor që vepron me këtë kategori nxënësish si në sistemin publik dhe jopublik të sistemit arsimor parauniversitar.

Guida ka trajtuar në formë udhëzuese dhe shpjeguese gjithë legjislacionin shqipëtar që garanton të drejtën për arsimim për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuar. Kushtetutën e rsh Ligjin nr. 7952 datë 21.06.1995 (i ndryshuar) "Për sistemin arsimor parauniversitar" "Dispozitat normative (Për shkollat publike) për arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta", Ligjin nr. 8872 datë 29.03.2002 (i ndryshuar) "Për arsimin dhe formimin profesional në RSh" si dhe dokumentat politik dhe strategjik që veprojnë në këtë fushë.

Duke shpresuar se do ti vijmë sado pak në ndihmë me anë të botimit të kësaj guide, falënderojmë **Komitetin Suedez të Helsinkit** (Swedish Helsinki Committee) për mbështetjen e tij financiare në ndihmë të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri.

Shënim: Gjithçka që është shpjeguar në këtë guidë nuk ka fuqi ligjore dhe asgjë në këtë guidë nuk zëvendëson kërkesat e ligjit.

Legjislacioni Shqipëtar që garanton të drejtën për arsim?

E drejta për arsimim është një nga të drejtat themelore të njeriut e cila duhet të gëzohet në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë nga të gjithë. Kushtetuta e RSh në nenin 57 dhe 59 të të tij garanton të drejtën për arsim për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pa dallim.

Parlamenti i RSh ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, dispozitat të të cilit kanë gjetur zbatim në ligjet e miratuara pas ratifikimit të kësaj konvente. Konkretisht Ligji nr.7952, datë 21.6.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar" Neni 3 garanton " *Shtetasit e Republikës së Shqipërisë gëzojnë të drejta të barabarta për t'u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimimit që përcakton ky ligj, pavarësisht nga gjendja sociale, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik*"

Cila është natyra e arsimit parauniversitar në Shqipëri

Me arsim parauniversitar në rradhë të parë do të kuptojmë sistemin arsimor 8 (tetëvjeçar) dhe sistemin e mesëm arsimor (i cili mund të jetë i përgjithshëm ose profesional).

Sipas ligjit për arsimin parauniversitar, arsimi parauniversitar në shqipëri është publik dhe ka karakter laik (jo fetar). Në institucionet arsimore publike ndalohet indoktrinimi ideologjik e fetar.

Arsimi në Republikën e Shqipërisë realizohet në institucione arsimore publike dhe private në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat do të shpjegojmë në materialin në vijim.

Pjesë e sistemit parauniversitar publik në Shqipëri është edhe "**Arsimi special publik**" garantuar në Ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar" Arsimi special publik synon që nëpërmjet përdorimit

të formave dhe metodave të veçanta të sigurojë zhvillimin sa më të plotë të mundësive të personave që paraqesin paaftësi fizike, mendore ose emocionale, në përputhje me nevojat e tyre dhe kërkesat për një jetë sa më dinjitoze. Për këtë kategori fëmijësh shteti merr masa për sigurimin gradual të kushteve të nevojshme për realizimin e integritimit. Në ato raste kur nevojat e tyre të veçanta nuk mund të plotësohen brenda sistemit shkollor, ngrihen klasa dhe institucione të posaçme, ku trajtimi i specializuar bëhet falas.

Cili është arsimi shkollor i detyrueshëm me ligj, për tu ndjekur nga personat që kanë mbushur moshën për arsimim?

Sipas kushtetutës së RSH arsimi shkollor i detyrueshëm është ai 8 – vjeçar dhe duhet të kryhet nga të gjithë fëmijët, pavarësisht *gjendjes së tyre sociale* apo *gjendjes së tyre shëndetësor*. Pra, pavarësisht se fëmija mund të ketë aftësi të kufizuara të lehtë apo të rëndë (kjo e specifikuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë) ky fakt nuk e kushtëzon kurrsesi nga ndjekja e niveleve të ndryshme të sistemit arsimor në përputhje me aftësitë e tij në të nxënë.

Ndërsa arsimi i mesëm i përgjithshëm është publik dhe i hapur për të gjithë. Gjë që do të thotë se të gjithë duhet të ndjekin dhe të përfundojnë sistemin 8 (tetëvjeçar) arsimor, dhe në rast të mos ndjekjes së tij parashikohen edhe sanksione (të cilat do të pasqyrojmë në vijim) ndërsa përsa i përket sistemin të arsimimit të mesëm apo të përgjithshëm kjo mbetet në zgjedhjen dhe dëshirën e individit për vazhdimin e këtij sistemi arsimor. Në këtë rast legjislacioni nuk parashikon sanksione në rast mosndjekje të tij.

Në lidhje me sistemin e mesëm (të përgjithshëm apo profesional) arsimor legjislacioni Shqipëtar ende nuk është shprehur konkretisht për nxënësit me aftësi të kufizuara mendore. Deri tashmë nuk ka udhëzime në lidhje me vazhdimin e kësaj shkolle nga kjo kategori fëmijësh, gjë që ka bërë që nxënësit me aftësi të kufizuara mendore të ndjekin qendrat rezidenciale ditore (të cilat janë të kufizuara në numër) apo të qëndrojnë të izoluar në shtëpi pa

kurrëfarë mundësie për tu ndjerë të integruar në shoqëri.

Ndërsa për kategoritë e tjera të aftësisë të kufizuara kjo e drejtë është e garantuar, pavarësisht se në praktikë ndeshën shumë vështirësi për shkak të barrierave ndërtimore apo barrierave të tjera teknike që të verbrit apo para-tetraplegjikët ndeshin çdo ditë.

Si edhe është e garantuar nga kushtetuta e RSh, arsimi i detyrueshëm, si edhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. Ndërsa porsa i përket shkollave private, sistemi arsimor do të ndiqet sipas kushteve të përcaktuara prej këtyre institucioneve.

Ç'farë garanton Strategjia Kombëtare e personave me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit gjithëpërfshirës?

E drejtë për arsim gjithëpërfshirës është garantuar edhe në Strategjinë Kombëtare të Personave me aftësi të Kufizuara, miratuar me VKM nr. 8 datë 07.01.2005, si një e drejtë që është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në objektivat dhe planin e veprimit të saj, konkretisht;

- Të sigurohet mundësia e arsimimit për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke i dhënë prioritet arsimit gjithëpërfshirës.
- Krijimi në shkollë i mjediseve burimore për punë më specifike me grupe fëmijësh
- Regjistrimi me prioritet i këtyre të rinjve në shkollat e mesme profesionale.
- Të përmirësohet dhe modernizohet procesi mësimor edukativ në shkollat speciale
- Sigurimi i lehtësirave , si transport, etj. për fëmijët me Ak nga zonat më të largëta për të ndjekur shkollat speciale.
- Krijimi dhe shtrirja graduale e shkollave e kopshteve të integruara.
- Krijimi dhe shtrirja graduale e shërbimeve psikopedagogjike dhe psikosociale në shkollat e integruara dhe në kopshtet
- Të krijohen struktura të shërbimeve psikopedagogjike e psikosociale pranë shkollave, duke patur në përbërje 1 psikolog, 1

punonjës social dhe 2-3 mësues me kohë të pjesshme dhe më pas të arrihet në shërbime të qëndrueshme duke filluar nga qytetet e mëdha (qendra rajonale), ku ka universitete.

Ç'do të kuptojmë me termin nxënës me aftësi të kufizuara?

Sipas Dispozitave Arsimore me termin -nxënës me nevoja të veçanta ose me aftësi të kufizuara, do të kuptojmë të gjithë ata fëmijë ose të rinj që paraqesin veçori anatomo-funksionale specifike dhe që për edukimin dhe arsimimin e tyre shkolla publike ndesh vështirësi, të cilët mund të jenë me aftësi të kufizuara të natyrës mendore, fizike, shqisore ose organike.

Sa është moshë e detyrueshme për pranimin në shkollë të fëmijës me aftësi të kufizuara si mendore/fizike?

Në Republikën e Shqipërisë fëmija, që ka mbushur moshën 6 vjeç deri 1 ditë para fillimit të vitit mësimor, përfshihet në detyrimin shkollor.

Moshë e pranimit në shkollat e veçanta/ shkolla speciale është 6 - 10 vjeç në klasën e parë dhe për mbarimin e shkollës nxënësi mund të qëndrojë deri në moshën 19 vjeç.

Drejtoria Arsimore (DA)

Drejtoria Arsimore (DA) është organi më i lartë administrativ publik i arsimit në nivel vendor. DA drejton, organizon dhe përgjigjet për funksionimin e tërë punës së institucioneve arsimore dhe cilësinë e arsimit në juridiksionin e saj.

Inspektimi i Planeve Mësimore Edukative (PME) në shkolla është një e drejtë dhe detyrë vetëm e DA apo e grupeve të specialistëve që ajo autorizon zyrtarisht.

Kualifikimi i mësuesve është një e drejtë dhe detyrë e DA. Kualifikime të kësaj shkalle mund të realizohen dhe nga ekspertë të institucioneve të specializuara me miratim të DA.

Studimet për nevojat e personelit mësimor, numrin e klasave, fondin e pagës si dhe për prognozën e zhvillimeve arsimore janë një e drejtë dhe detyrë e DA, që realizohet në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor.

Institucione të tjera, organizata, shoqata, fondacione, etj., mund të hyjnë në shkolla për të vëzhguar zhvillimin e procesit të mësimdhënies apo të kushteve në institucionet shkollore vetëm me miratimin paraprak të Drejtorisë Arsimore.

Detyrimi i Drejtorive Rajonale Arsimore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Sipas Dispozitave Normative të për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, dalë në zbatim të Ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Per sistemin arsimor parauniversitar", Drejtoritë Arsimore kanë këto detyrime në lidhje me rregjistrimin dhe nxitjen për rregjistrim të të gjitha kategorive të fëmijëve me aftësi të kufizuara, për herë të parë në institucionet shkollore;

Së pari, drejtoritë e shkollave brenda muajit Prill, të çdo viti, duhet të marrin informacion nga Zyrat e Gjendjes Civile, që e mbulon atë si zonë, mbi listën e fëmijëve 6-vjeçarë dhe bën verifikimin e tyre.

Për nxënësit e klasave V – VIII, që përfshihet në detyrimin shkollor, vendbanimi i të cilit ndodhet mbi 5 km larg nga shkolla, trajtohet në konviktet e shtetit. Është detyrë dhe përgjegjësi e DA dhe e pushtetit vendor të kujdesen dhe të sigurojnë shkollimin e këtij kontingjenti nxënësish. Për kategorinë e nxënësve me aftësi të kufizuara Drejtoritë Arsimore marrin informacion, nga Drejtoritë e shkollave të veçanta (shkollat speciale) ose edhe nga burime të tjera të cilat mund të jenë OJF që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuara apo në mënyrë direkte nga prindërit e tyre. Gjithashtu, informacion më të plotë dhe të detajuar Drejtoritë Arsimore Rajonale mund të marrin edhe nga Zyrat e Përkrahjes Sociale pranë Bashkive (apo Njësi Bashkiake) ose Komunave e cila i'u bën

të njohur drejtorëve të shkollave të veçanta listat e fëmijëve 6-vjeçarë me aftësi të kufizuara, që nuk janë regjistruar në klasën e parë të shkollave të zakonshme. Në këtë mënyrë Drejtoria e Shkollës së veçantë bën verifikime për pranimet e reja apo për nxitjen e prindërve dhe të afërmeve të tyre për regjistrimin e kësaj kategorie nxënësish.

Cila është fusha e zbatimit të “Dispozitive Normative për shkollat publike”?

Dispozitat Normative për shkollat publike zbatohen në të gjitha institucionet shkollore dhe parashkollore publike (kopshte, shkolla 8-vjeçare dhe të mesme me kohë të plotë apo të shkurtuar/ pjesëshe, si dhe në institucionet e arsimit special), që përfshihen në rrjetin e institucioneve shkollore parauniversitare të Republikës së Shqipërisë.

Si realizohet arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuara, sipas dispozitive normative?

Arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuara realizohet në dy forma:

- në shkollat e arsimit publik (shkollat e zakonshme), në kuadrin e gjithëpërfshirjes, ku nxënësit me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë të mësojnë në të njëjtat klasa së bashku me nxënësit e tjere,
- nëpërmjet integritit të tyre në shkolla apo klasa publike të veçanta (speciale), sipas kategorive e specifikave që ata paraqesin, të cilat janë pjesë e rrjetit të institucioneve shkollore parauniversitare publike në Shqipëri. Të tilla janë shkollat të cilat janë ngritur posaçërisht dhe funksionojnë aktualisht në disa qytete të Shqipërisë si për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara mendore, në të dëgjuar apo që nuk shikojnë.

Si realizohet procesi i pranimit në këto shkolla?

Nxënësi me aftësi të kufizuara pranohet në institucionet arsimore nga një komision i veçantë i përbërë nga drejtori i shkollës (kryetar), dy mësues specialistë dhe mjeku specialist përkatës.

Po për ata fëmijë për të cilët shkollat publike nuk ofrojnë kushtet e nevojshme për arsimim, në cilat institucione mund të regjistrohen për të vazhduar arsimimin?

Fëmijët me aftësi të kufizuara mendore apo fizike të rënda, në pamundësi të trajtohen në shkollat e veçanta, mund të trajtohen edhe në institucione të tjera. Të tilla mund të jenë qendra ditore apo rezidenciale të ngritura nga shteti apo privatë apo OJF të ndryshme. Informacione të mëtejshme të interesuarit mund të marrin pranë Bashkive apo Komunave ku ata janë rezidentë, pranë Drejtorive Arsimore në rrethin ku banojnë, apo nga OJF të ndryshme, që punojnë në fushën e aftësisë të kufizuara në rrethin ku ata banojnë.

Sa është kohëzgjatja e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat speciale?

Arsimimi në këto shkolla, normalisht kryhet në 9 vjet (arsimi 8 – vjeçar), duke përfshirë këtu dhe vitin përgatitor për ata fëmijë, që kanë nevojë për parapërgatitje.

Ku duhet të drejtohem për të marrë informacion të detajuar mbi arsimimin e fëmijës me aftësi të kufizuara?

Duke qënë se shkollat e veçanta varen nga drejtoritë arsimore (DA) të rretheve ku ndodhen, një informacion i gjerë mund të merret pranë

tyre, por pa përjashtuar informacionin që mund të na japin njësitë e qeverisjes vendore apo OJF të ndryshme.

Cili është dokumentacioni që duhet të plotësohet për rregjistrimin për herë të parë të fëmijës në shkollë?

Regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë të shkollës së arsimit të detyruar bëhet me këto dokumente:

- Çertifikata e lindjes.
- Çertifikata e vaksinimeve e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- Regjistrimi i fëmijëve në klasat e tjera të shkollës së arsimit të detyruar bëhet me këto dokumente:
- Dokumenti i përfundimit të klasës së mëparshme.
- Çertifikata e vaksinimeve e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Çfarë dokumentacioni duhet të plotësojë për rregjistrim në shkollë nxënësi me aftësi të kufizuara?

Për rregjistrimin në shkollë, prindrit apo kujdestarët e nxënësit me aftësi të kufizuara, duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Çertifikata e lindjes.
2. Raporti mjekësor për njohjen e gjendjes së fëmijës.
3. Vendimi i komisionit të pranimit.
4. Çertifikata e vaksinimit.

Po në ato raste kur fëmija vjen prej një shkolle publike, çfarë dokumentash duhet të plotësojë?

Në rast se një nxënës me aftësi të kufizuara vjen nga shkolla publike ose jopublike e zakonshme i nënshtrohet komisionit për t'u pranuar në klasën e

përshtatëshme. Në këtë rast për nxënësin paraqitet një karakteristikë nga shkolla që vjen dhe bashkëngjiten të gjitha dokumentat e sipërsënuara.

Sa është numri i nxënësve me aftësi të kufizuara, i detyrueshëm për çdo klasë?

Nxënësit me aftësi të kufizuara, vërtetuar si të tillë nga organet shëndetësore, kanë të drejtë të arsimohen në shkolla publike të zakonshme 1 - 2 nxënës për klasë. Për këta nxënës shkolla merr masa dhe bën përpjekje të gjithanëshme për arsimimin, edukimin dhe integrimin e tyre në jetën e klasës dhe të shkollës.

Në kompetencë të cilit institucion është hapja e shkollave speciale?

Hapja e shkollave të veçanta/speciale është kompetencë e Ministrisë së Arsimit dhe e Shkencës. Pasi të jetë marrë miratimi nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës hapja e klasave të veçanta në qytet është kompetencë e bashkive, ndërsa në komuna e këshillit të rrethit. Numri i nxënësve për klasë është 10 - 12 fëmijë.

Veprimtaria mësimore edukative në institucionet e veçanta realizohet në përputhje me të gjithë dokumentacionin ligjor, që zbatohet në shkollat publike. Nga pikëpamja strukturore shkollat e veçanta organizohen në përputhje me specifikën e vështirësive që paraqesin këta nxënës.

Çfarë lehtësirash kanë mësuesit që punojnë me këtë kategori nxënësish?

Për t'u ardhur në ndihmë dhe për të lehtësuar punën e mësuesve, që japin mësim në klasa ku ka nxënës me aftësi të kufizuara (1 – 2 nxënës për klasë), mund të përfitojnë një nga alternativat e mëposhtme:

- a) Për çdo nxënës me aftësi të kufizuara ulet me 3 (tre) numri i nxënësve të klasës.
- b) Mësuesit i ulet me 2 (dy) orë mësimore ngarkesa javore.
- c) Për çdo 4 (katër) orë mësimi të zhvilluara, mësuesi paguhet 1 (një) orë suplementare .

A ka të drejtë nxënësi me aftësi të kufizuara të largohet nga shkolla në të cilën është rregjistruar për të shkuar në një shkollë tjetër në të cilën ai ose prindërit e tij e gjykojnë më të mirë?

Nxënësi me aftësi të kufizuara, mbështetur në kërkesën me shkrim të prindërve dhe pas një konsultimi me personelin e mësuesve, mund të largohet nga shkolla në çdo kohë kur gjykohet se ata nuk përfitojnë nga këto institucione, apo kur ekzistojnë forma e mundësi të tjera më efektive.

A mund të realizohet arsimimi i nxënësit me aftësi të kufizuara edhe në ambientin shtëpiak?

Nxënësi, që përfshihet në detyrimin shkollor, në raste të veçanta, kur aksidentohet apo sëmuret rëndë dhe nuk mund të lëvizë e të ndjekë mësimet në shkollë, vërtetuar kjo nga shërbimi shëndetësor, lejohet të marrë mësim në shtëpi. Për këta nxënës shkolla kontribuon me programe të reduktuara mësimore të hartuara nga mësuesit dhe të miratuar nga DA. Por kjo dispozitë nuk vlen për nxënësit e shkollës 8-vjeçare, i cili ka munguar mbi 40% të orëve të mësimi të zhvilluara gjatë një semestri, me dhe pa arsye në një lëndë. Në vartësi të kushteve specifike të shkollës, drejtori cakton mësues të veçantë për ta konsultuar nxënësin në shtëpi, të paktën një herë në muaj, duke e konvertuar kohën e konsultimeve në orë mësimore që llogariten në ngarkesën javore të tij.

Gjithashtu, personeli mësimor edukativ bën përpjekje që nxënësit me aftësi të kufizuara të mos largohen nga shkolla. Në rast se ata largohen,

arsimimi i tyre mund të vijojë në shtëpi nëse prindi e dëshiron një gjë të tillë. Arsimimi në shtëpi kryhet edhe për ata nxënës që mungojnë në shkollë me periudha të gjata.

Mësuesit që do të konsultojnë nxënësit në shtëpi, sipas mundësive që ka shkolla speciale, duke u lehtësuar nga ndonjë detyrë tjetër ose caktohen mësues që nuk kanë plotësuar ngarkesën mësimore javore.

Çfarë programesh mësimore duhet të ndjekimin nxënësit me aftësi të kufizuara?

Nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar si të tillë me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë në Punë, ndjekin mësimet me programet e zakonshme mësimore, duke bërë përshtatjet e duhura sipas nevojave dhe mundësive të tyre (ose me programet mësimore të shkollave të veçanta).

A ndryshon programi dhe vëllimi i njohurive që marrin nxënësit me aftësi të kufizuara nga një kategori në tjetrën?

Programi mësimor është i përcaktuar në mënyrë të veçantë për kategori të ndryshme nxënësish me aftësi të kufizuara, psh..

- *Nxënësit e verbër* marrin po atë vëllim njohurish që marrin edhe nxënësit e shkollave 8 -vjeçare të zakonshme.
- Ndërsa *nxënësit që nuk dëgjojnë*, si dhe *nxënësit me aftësi të kufizuara fizike*, marrin njohuri në bazë të programeve mësimore të thjeshtuara të arsimit 8 – vjeçar, të përshtatura sipas mundësive dhe aftësive të tyre.
- Përveç njohurive mësimore, me një program të zgjeruar në mesimin e punës, nxënësve me aftësi të kufizuara u jepen edhe njohuri fillestare praktike në profesione të thjeshta.

Ç'farë lloj tekstesh mësimore përdoren për PAK?

Për nxënësit e shkollave të veçanta (speciale) përdoren tekste të arsimit të përgjithshëm duke bërë përshtatjet e nevojshme sipas programeve të miratuara dhe sipas aftësive të nxënësve.

Për nxënësit e verbër përdoren edhe tekste speciale me zmadhim dhe të shtypura në teknikën e brailit, si dhe kasete, ndërsa për nxënësit që nuk dëgjojnë e nuk flasin edhe tekste për mësimin e gjuhës së folur dhe komunikimin global. Në zbatimin e teksteve e programeve mësimore mbahen parasysh nevojat dhe specifikat e fëmijëve. Sipas vështiresive që paraqesin nxënësit, zbatimi i tyre bëhet në mënyrë krijuese. Për nxënësit të veçantë, gjendja e të cilëve është nën nivelin minimal të programit mësimor ose kur ai paraqet specifika krejtësisht të veçanta, do të punohet me plane edukative individuale.

A mund të kryejnë orë mësimore nxënësit me aftësi të kufizuar së bashku me nxënësit e tjerë?

Drejtoritë e shkollave të veçanta krijojnë mundësi që për disa lëndë mësimore, nxënësit me aftësi të kufizuara ta zhvillojnë mësimin së bashku me nxënësit e shkollave 8 - vjeçare të zakonshme, duke vendosur lidhje bashkëpunimi me to. Nxënësit gjatë kësaj kohe shoqërohen dhe ndihmohen nga personeli mësimor - edukativ i shkollës së veçantë.

Bashkëpunimi me shkollat e tjera 8 - vjeçare bëhet me miratimin e drejtorive arsimore. Përveç mësimin organizohen dhe aktivitete edukative argëtuese të përbashkëta.

Si bëhet vlerësim i nxënësve me aftësi të kufizuar?

Në përfundim të klasës së tetë nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e veçanta/ speciale provohen në drejtim të aftësimin të tyre të

përgjithshëm shoqëror dhe të njohurive praktike profesionale të fituara në mësimin e punës.

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara bëhet me nota ose me shprehje sintetizuese njësoj si për të gjithë nxënësit e tjerë, por ata kalojnë nga klasa në klasën pasardhëse pa mbetje. Ky rregull nuk shërben për nxënësit të cilët ndjekin Institutin e të verbërve.

Nxënësit që nuk dëgjojnë, do të provohen edhe në drejtim të aftësimin të tyre për të komunikuar; për **Nxënësit e verbër** organizohen provimet e lirimit.

Nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme në provimet e lirimit vlerësohen në bazë të programit të veçantë që është aplikuar për ta. Tezat e provimeve të lirimit për këtë kategori nxënësish hartohen nga vetë shkolla dhe miratohen në Drejtorinë Arsimore.

Ç'farë parashikon ligji për atë kategori nxënësish me aftësi të kufizuar të cilët kanë moshë më të madhe se nxënësit që mësojnë në klasën që ai frekuenton?

Për nxënësit të veçantë, të cilët kanë zhvillim anatomo-fiziologjik normal, por që mosha e tyre për arsye të ndryshme është më e madhe se mosha për klasën të cilën ata frekuentojnë, mund të punohet me programe të veçanta dhe ata mund të marrin deri edhe në dy vite mësimore brenda një viti.

Në këto raste plotësohet një procesverbal i firmosur nga mësuesi, drejtori i shkollës dhe inspektori, që ndjek arsimin special në drejtoritë arsimore.

Bashkëpunimi i personelit arsimor me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuar

Personeli mësimor-edukativ mban lidhje të ngushta me prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuar. Ata ftohen herë pas here të marrin pjesë në procesin mësimor edukativ, mbahen afër dhe trajtohen për mënyrën e sjelljes dhe të trajtimit të fëmijëve në shtëpi. Për hartimin e planeve

(vjetore, mujore) dhe për organizimin e aktiviteteve edukative-argëtuese, të cilat kanë vlera të mëdha për zhvillimin e këtyre fëmijëve, bashkëpunimi dhe marrja e mendimit të prindërve konsiderohet normë e domosdoshme.

Në rast se jam nxënës me aftësi të kufizuar, a jam i detyruar të ndjek lëndën e edukimit fizik?

Nxënësi, që me vendim të komisionit mjekoligjor kufizohet nga ngarkesa fizike ose është me të meta fizike jo të lindura merr pjesë në mësimin e edukimit fizik mbi bazën e një programi të reduktuar mësimor të hartuar nga mësuesi, që mban parasysh edhe këshillat e mjekut. Për rastet e tjera, kur nxënësi ka aftësi të kufizuar fizike apo dhe ndërthurje aftësish të kufizuara, nuk është i detyruar ta ndjek këtë orë mësimi. Por mund të zëvendësohet me aktivitete të tjera të miratuara posaçërisht për këtë kategori nxënësish.

Cilat janë të drejtat e nxënësve gjatë sistemit shkollor

- Nxënësi ka të drejtë të marrë mësim dhe edukim në shkollë në kushte normale, të sigurta dhe të përshtatëshme shëndetësore, të cilat përcaktojnë dhe kohën për pushim, për aktivitete të lira në përputhje me psikologjinë, aftësitë, interesat dhe moshën e tij, si dhe të ndjekë rrugët e format e mundshme, që zbulojnë dhe zhvillojnë prirjet e tij në fushën e shkencës, artit dhe sportit.
- Individualiteti dhe dinjiteti njerëzor i nxënësit respektohet; ai mbrohet nga dhuna fizike e psikologjike, diskriminimi e veçimi. Në shkollë janë kategorikisht të ndaluara ndëshkimet fizike apo trajtimet poshtëruese e denigruese të nxënësit.

Nxënësi ka të drejtë :

- a) Të shfaqë lirisht mendimin e tij në të gjitha format: me gojë, me shkrim, publikisht, pa cënuar të drejtat e të tjerëve.
- b) Të njihet me të drejtat e tij (dokumentet ndërkombëtare e kombëtare), t'i përhapë ato dhe të kërkojë përmbushjen dhe

respektimin e tyre prej të tjerëve.

- c) Të marrë pjesë aktive në plani mësimor edukativ (PME); të shfrytëzojë laboratorët, kabinetet, bibliotekën, palestrën e shkollës, kompjuterët, mjedise e pajisje të shkollës, sipas rregullave përkatëse.
- d) Të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme edukative, argëtuese, shkencore, kulturore - artistike, sportive.
- e) Të bëjë zgjedhje të lirë të orientimit shkollor për lëndët me zgjedhje apo fakultative.
- f) Të marrë pjesë në mbledhje të ndryshme të klasës e shkollës. Të shprehë opinionin e vet për PME, programet e tekstet dhe për punën e mësuesve; të informohet për probleme, që lidhen me personin e tij, t'u paraqesë drejtorit të shkollës dhe mësuesve probleme, që kanë të bëjnë me të, dhe të marrë përgjigje jo më vonë se 30 ditë nga koha e paraqitjes së tyre.
- g) Të zgjidhet dhe të zgjedhë të tjerët në këshilla, shoqata, organizma të ndryshme, që përcaktohen në ligj apo në DN, si dhe të përfaqësojë interesat e klasës apo të një grupi nxënësish në to. Të aderohet në organizata shoqërore në përshtatje me statusin e tyre, apo në shoqata shkencore, klube sportive, grupe kulturore-artistike brenda e jashtë shkolle.
- h) Të marrë përkujdesin shëndetësor e stomatologjik nga qendrat mjekësore sipas organizimit përkatës, që lejon legjislacioni në fuqi.
- i) Të marrë në kohë (jo më vonë se 10 ditë) nga mësuesi punimet e tij me shkrim (provime, hartime etj.) për t'i studiuar e për të reflektuar mbi to.
- j) Të ankohet për vlerësimin nga mësuesit te drejtori i shkollës, i cili, kur e shikon të arsyeshme, ngre një komision me 3 mësues (ku merr pjesë dhe mësuesi i lëndës) që shqyrton ankesën.

Nxënësit e shkollave të mesme profesionale apo shkollave të specializuara, përveç shpjegimeve të lartpërmendura, i sigurohen kushte të sigurta pune gjatë praktikave profesionale; ai trajtohet si praktikant, si prodhues edhe si përfitues në bazë të rregullave përkatëse të këtyre shkollave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Cilat janë detyrat e nxënësve gjatë sistemit arsimor?

Detyrat

1.

- a) Të mbajë qëndrim të drejtë e të kulturuar në shkollë e jashtë saj.
- b) Të njohë dhe të respektojë detyrimet e përcaktuara në PM të shkollës (lëndët, ngarkesën mësimore për çdo lëndë dhe atë javore).
- c) Të zbatojë me përpikmëri orarin e mësimave.
- d) Të mësojë dhe të përgatitet sistematikisht në çdo lëndë; të kryejë me korrektësi e në përputhje me aftësitë e veta detyrat, që i ngarkohen nga mësuesit e drejtoria e shkollës.
- e) Të respektojë rregulloren dhe disiplinën në shkollë, të mos pengojë mbarëvajtjen e plani mësimor edukativ (PME) në klasë, shkollë apo studimin e punën e nxënësve të tjerë.
- f) Të respektojë e të mbajë qëndrim korrekt ndaj mësuesve, instruktorëve, drejtorisë, personelit administrativ, teknik e ndihmës të shkollës, në mjediset brenda e jashtë saj.
- g) Të sigurojë pajisjen me tekste, fletore dhe bazën e nevojshme materiale. Të jetë i pajisur çdo ditë me bazën materiale mësimore sipas kërkesave të çdo lënde.
- h) Të mos çenjë pronën e shtetit dhe të tjerëve. Të kujdeset dhe të kontribuojë për mbrojtjen e saj. Prindi të zhdëmtojë dëmet që ai shkakton kundrejt vlerave sipas rregullave në fuqi.
- i) Të mbrojë mjedisin nga të gjithë llojet e ndotjeve. Të mbajë higjienë vetjake, të kujdeset dhe të kontribuojë për higjienën e klasës e të shkollës.
- j) Veshja e paraqitja e tij të jetë korrekte, pa teprime, e përshtatshme me moshën që ai ka, në përputhje me kërkesat e normat e bashkëjetesës në shoqëri dhe me rregulloren e brendshme të shkollës.
- k) Nxënësi konvikt ka për detyrë të zbatojë me korrektësi kërkesat, normat dhe rregullat e jetesës në konvikt të përcaktuara në rregulloren e konviktit.

2.

- a) Ndalohet shkelja e cënimi i të drejtave të tjerëve.
- b) Të mos ushtrojë asnjë lloj dhune fizike apo psikologjike dhe të mos pajtohet me akte të pakulturuara, vagabondazhi, fyese dhe poshtëruese në mjediset e shkollës dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tyre.
- c) Janë kategorikisht të ndaluara për nxënësin pirja e duhanit, pijet alkoolike, përdorimi e shpërndarja e drogës, mbajtja e armëve të zjarrit dhe atyre të ftohta.
- d) Gjatë punimeve me shkrim (hartime, provime, testime e të tjera të kësaj natyre) në klasë është i ndaluar kopjimi nga ana e nxënësit.
- e) Nxënësi i shkollës me kohë të shkurtuar mund të pijë duhan vetëm në një vend të caktuar në rregulloren e brendshme të shkollës.

Cilat janë të drejtat dhe detyrat e prindërve, në lidhje me procesin mësimor?

Të drejtat e prindërve:

- a) t'u kërkojnë organeve arsimore dhe autoriteteve sigurimin e kushteve normale dhe shëndetësore për mësim dhe edukim;
- b) të kontribuojnë në realizimin e detyrave të shkollës, në mbarëvajtjen e plani mësimor edukativ (PME), në integrimin optimal të fëmijëve në jetë, punë dhe shoqëri;
- c) të bëjnë zgjedhje të lirë të institucionit shkollor të fëmijëve, që i përfshin detyrimi shkollor, brenda rregullave dhe mundësive të përcaktuara në DN (Dispozita Normative të arsimit);
- d) të kërkojnë informacion për programet mësimore, për objektivat, rregullat dhe vepimtaritë shkollore;
- e) të kërkojnë rregullisht informacion të qartë për zhvillimin e fëmijëve, për sjelljet e rezultatet në shkollë; të kërkojnë këshilla dhe ndihmë për edukimin familjar të fëmijës;
- f) të zgjidhen dhe të zgjedhin të tjerë në bordin e shkollës apo në

- organizmat konsultative të saj të përcaktuara në DN dhe të përfaqësojnë interesat e një grupi prindërisht, kur autorizohen prej tij;
- g) të marrin pjesë në veprimtaritë jashtëshkollë dhe në ato mësimore, që përcakton rregullorja e brendshme e shkollës;
 - h) të ankohen dhe të propozojnë me shkrim pranë drejtorit të shkollës, personelit mësimor apo bordit të shkollës dhe të marrin përgjigje jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i tyre.

Detyrime specifike të prindërve:

- a) të sigurojnë frekuentimin në shkollë të fëmijëve, në mënyrë të veçantë të atyre që përfshin detyrimi shkollor;
- b) të njohin dhe të respektojnë detyrimet ligjore, rregullat dhe procedurat e PME, që përcaktohen në DN apo në rregulloren e brendshme të shkollës;
- c) të marrin masat e nevojshme dhe në kohë për pajisjen e fëmijëve me tekstet mësimore e bazën materiale që kërkojnë lëndët mësimore;
- d) të respektojnë të drejtat e fëmijëve dhe të ndihmojnë në edukimin e tyre;
- e) të vendosin kontakte të rregullta me mësuesit e fëmijëve të tyre;
- f) të ndihmojnë fëmijët e tyre të përshtaten me kërkesat e rregullat e shkollës dhe të integrohen në jetën e komunitetit.

Prindërit e nxënësit me aftësi të kufizuar

Personeli mësimor-edukativ mban lidhje të ngushta me prindërit, dhe në mënyrë të veçantë me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Ata ftohen herë pas here të marrin pjesë në procesin mësimor-edukativ, mbahen afër dhe trajnohen për mënyrën e sjelljes dhe të trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shtëpi. Për hartimin e planeve (vjetore, mujore) dhe për organizimin e aktiviteteve edukative-argëtuese, të cilat kanë vlera të mëdha për zhvillimin e këtyre fëmijëve, bashkëpunimi dhe marrja e mendimit të prindërve konsiderohet normë e domosdoshme.

A lejohet punësimi i fëmijëve të cilët janë të përfshirë në detyrimin shkollor?

Jo, punësimi i fëmijëve që përfshihen në detyrimin shkollor, ndalohet kategorikisht. Kur vërtetohen raste të punësimit të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, punëdhënësi shtetëror ose privat dënohet për kundërvajtje administrative nga inspektori i punës me gjobë 100 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë 200 000 lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim apo protestë, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

Cilat janë sanksionet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në lidhje me detyrimin për ndjekjen e procesit mësimor?

Kur nxënësit e moshës 6 deri 16 vjeç, të cilët i përfshin detyrimi shkollor, mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, prindërit e tyre dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë, si vijon:

Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye 30-50 për qind të kohës në dy muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 5 000 deri në 15 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti, gjoba është 25 000 lekë.

Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye mbi 50 për qind të kohës në dy muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 25 000 deri në 35 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti ose braktisje të shkollës, gjoba është 50 000 lekë.

Vendimi i gjobës jepet nga drejtori i Drejtorisë Arsimore në rreth, në bazë të propozimit të drejtorit të shkollës.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim dhe protestë brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

Kush përjashtohet nga gjrobat?

Përjashtohen nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë shqiptare a të huaj, brenda ose jashtë vendit, me kusht që të paraqesin dokumentin e regjistrimit pranë drejtorisë së shkollës së vendbanimit të tyre.

Duke qënë se e drejta për arsimim është e lidhur ngushtë me formimin profesional, një vend të rëndësishëm në këtë guidë zë edhe trajtimi i Ligj Nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"

Cili është qëllimi i këtij ligji?

Qëllimi i këtij ligji është të mbështesë zhvillimin e një sistemi të përbashkët të arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, i cili mund t'u përshtatet ndryshimeve shoqërore, ekonomike e teknologjike, nevojave të tregut të punës, si dhe të mundësojë një shfrytëzim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore.

A mund të jetë formimi profesional vetëm publik?

Ashtu si sistemi arsimor edhe formimi profesional është publik dhe jopublik. Në këtë mënyrë ky shërbim mund të ofrohet edhe nga strukturat shtetërore ashtu edhe nga struktura jo publike apo jo fitim prurëse (të cilat janë paraqitur në mënyrë të detajuar më poshtë), pasi ato të jenë liçencuar nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta.

Cilat janë llojet e arsimit dhe formimit profesional?

Arsimi dhe formimi profesional përbëhet nga:

- arsimi profesional;
- arsimi i mesëm teknik;
- formimi profesional;
- apo forma të tjera të arsimit dhe formimit profesional që përcaktohen rast pas rasti me ligj.

Cilat institucione ofrojnë arsimim dhe formimit profesional?

Institucionet e arsimit dhe formimit profesional janë:

- a) Shkollat profesionale publike dhe jopublike, të nivelit të parë dhe të dytë, të cilat ofrojnë arsimimin teknik të nxënësve pas arsimit të detyruar. Këto shkolla realizojnë përgatitjen profesionale me karakter të theksuar praktik dhe u japin nxënësve arsimimin bazë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar për një specialitet të dhënë.
- b) Shkollat teknike publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë arsimimin teknik të nxënësve pas arsimit të detyruar. Këto shkolla u japin nxënësve një arsimim bazë të gjerë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e teknikut të kualifikuar për një specialitet të dhënë.
- c) Qendrat dhe kurset e formimit profesional, të cilat organizojnë formim, riformim dhe riaftësim profesional, për fitimin e aftësive të nevojshme profesionale për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.
- ç) Institucionet e specializuara të arsimit dhe formimit profesional për grupe të veçanta.
- d) Ndërmarrjet.
- dh) Institucionet e tjera publike dhe jopublike, veprimtaria e të cilave rregullohet me akte të veçanta nënligjore.

Cilat kategori mund të jenë përfituese të arsimimit dhe formimit profesional?

Arsimi dhe formimi profesional mund të ndiqet nga kategoritë e mëposhtme:

- të gjithë nxënësit që kanë përfunduar arsimin e detyruar;
- personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç, që janë kërkues pune dhe/ose dëshirojnë të formohen profesionalisht;
- grupe të veçanta, që dëshirojnë riaftësim profesional, si personat me aftësi të kufizuara, nënat me shumë fëmijë, personat nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë.

Në shkollat profesionale dhe në ato të mesme teknike publike dhe jopublike pranohen të gjithë individët që kanë përfunduar arsimin e detyruar dhe kanë marrë dëftesën e lirisë.

Në kurset e ndryshme të formimit, të riformimit dhe të riaftësimit profesional publik dhe jopublik, të akredituar, marrin pjesë të rinjtë dhe të rriturit, të cilët pranojnë programet përkatëse të miratuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Cili është institucioni kompetent për rregjistrimin e institucioneve të arsimimit dhe formimit profesional dhe dokumentacioni që ato duhet të plotësojnë për rregjistrim?

Të gjitha institucionet që ofrojnë arsimin dhe formimin profesional duhet të regjistrohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Bazuar në udhëzimin nr. 437, datë 3.3.2003 "Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional" institucionet që do të ofrojnë arsimim dhe formim profesional duhet të plotësojnë këto dokumenta.

a) Për subjekte shtetërore:

- i) Vërtetimi i regjistrimit si ofrues i formimit profesional në zyrën e punësimit.

- ii) Programi i kurseve që do të hapë.
 - iii) Curriculumet e stafit kualifikues.
 - iv) Deklarata për dhënie informacioni në lidhje me ecurinë e formimit në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale në mbarim të çdo kursi.
 - v) Deklarata për dhënien e informacionit SHKP në lidhje me procesin e formimit.
 - vi) Leja higjieno-sanitare e noterizuar.
 - vii) Marrëveshja me sigurimet shoqërore për stafin kualifikues e noterizuar.
 - viii) Diplomat dhe certifikatat të stafit kualifikues të noterizuara.
 - ix) Fatura e pagesës për marrjen e autorizimit.
- b) Per organizata jofitimprurëse dhe subjekte private:**
- i) Vërtetimi i regjistrimit si ofrues i formimit profesional në zyrën e punësimit.
 - ii) Dokument ose deklaratë ku të vërtetohet burimi i financimit (vetëm për organizatat jofitimprurëse.
 - iii) Vërtetim i regjistrimit në zyrën e tatimeve (vetëm për subjektet private).
 - iv) Një kopje e statutit e noterizuar.
 - v) Programi i kurseve që do të hapë.
 - vi) Curriculumet e stafit kualifikues.
 - vii) Deklarata për dhënie informacioni në lidhje me ecurinë e formimit në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale në mbarim të çdo kursi.
 - viii) Dokumente që vërtetojnë pronësinë ose marrjen me qira të ambienteve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit, si dhe të pajisjeve didaktike të nevojshme.
 - ix) Deklarata për dhënien e informacionit SHKP në lidhje me procesin e formimit.
 - x) Leja higjieno-sanitare.
 - xi) Marrëveshja me sigurimet shoqërore për stafin kualifikues.
 - xii) Diploma dhe certifikata të stafit kualifikues.
 - xiii) Fatura e pagesës për marrjen e autorizimit.

Dokumentet dorëzohen në dy kopje (njëra e noterizuar dhe tjetra fotokopje) dhe depozitohen në **Drejtorinë e Formimit Profesional në Sherbimin Kombëtar të Punësimit**, e cila i shqyrton, përgatit relacionin argumentues për licencimin e subjekteve dhe ia paraqet ato Drejtorisë së Politikave të Punësimit në MPÇS.

Sa është afati i liçencës?

Licenca është e vlefshme për një periudhë kohore një vit nga data e dhënies së saj. Në rastet kur kurset e organizuara nga subjektet e mësipërme janë dyvjeçare licenca është e vlefshme për 2 vjet. Në këto raste subjekti duhet të derdhë një tarifë 50% më të lartë, sesa tarifat e parashikuar për pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit prej 3000 lek që derdhet në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

Kohëzgjatja në arsimin dhe formimin profesional

Arsimi profesional publik dhe jopublik fillon pas mbarimit të arsimit të detyruar dhe sipas niveleve ka këtë kohëzgjatje: niveli i parë vazhdon deri në tre vjet dhe niveli i dytë vazhdon edhe dy vjet të tjerë pas nivelit të parë. Me mbarimin e nivelit të parë, krahas dëftesës së përfundimit të saj, nxënësit pajisen edhe me një certifikatë të aftësisë profesionale. Në përfundim të nivelit të dytë, nxënësit marrin dëftesën e pjekurisë, certifikatën e aftësisë profesionale dhe u njihet mbarimi i shkollës së mesme dhe mundësia e vazhimit të shkollës së lartë.

Arsimi i mesëm teknik publik dhe jopublik fillon pas mbarimit të arsimit të detyruar dhe vazhdon pesë vjet. Nxënësit që mbarojnë shkollat teknike publike dhe jopublike, krahas dëftesës së pjekurisë marrin edhe certifikatën e aftësisë tekniko-profesionale dhe mund të vazhdojnë shkollën e lartë.

Formimi profesional publik dhe jopublik zhvillohet nëpërmjet kurseve të formimit, të riformimit dhe të riaftësisë profesionale me kohëzgjatje nën tre vjet.

Si bëhet vlerësimi përfundimtar në arsimin dhe formimin profesional?

Vlerësimi përfundimtar i nxënësve dhe i kursantëve në arsimin dhe formimin profesional publik dhe jopublik, të akredituar, bëhet në bazë të provimeve, me pjesëmarrjen edhe të partnerëve socialë.

Në këtë mënyrë vlerësimi i tyre bëhet me anë të

- dëftesë, dëftesë përfundimi, dëftesë pjekurie, certifikatë e arsimit profesional, certifikatë e aftësisë tekniko-profesionale për nxënësit;
- dëshmi dhe certifikatë për kursantët.

Çfarë është Inspektoriati Kombëtar për Arsimin Parauniversitar (IKAP)?

IKAP është organizëm i veçantë në vartësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës.

IKAP bën vlerësimin e jashtëm të pavarur dhe objektiv të cilësisë së shkollës, mbështet institucionet arsimore (shkollat) në procesin e vetvlerësimit në partneritet me punën këshilluese dhe kualifikuese të Drejtorisë Arsimore për përmirësimin e cilësisë së shkollës.

Çfarë është Instituti i Studimeve Pedagogjike (ISP)?

Instituti i Studimeve Pedagogjike (ISP) është organizëm publik kombëtar, që varet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

ISP siguron këshilla dhe mbështetje profesionale për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe harton përbërës të caktuar kurrikulare për sistemin e arsimit parauniversitar. ISP ofron e garanton shërbime arsimore për shkollat dhe drejtoritë arsimore.

Ç'farë është Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve (QKAVP)

Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe e Provimeve (QKAVP) është organizëm publik i veçantë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. QKAVP vepron si njësi teknike, profesionale e mbështetëse për punonjësit e arsimit. Për kryerjen e detyrave të saj QKAVP mbështetet në funksionimin e rrjetit të bashkëpunorëve qendror e vendor.